



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

14-111/01- 0140339/21-1
Dt.19.07.2021

Në bazë të Nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 90/2010), Nenit 5, pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068, Nenit 4 dhe 5, të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik:

**KONKURS
PËR PLOTËSIMIN VENDEVE TË PUNËS**

DREJTORIA E ARSIMIT

Nr.	Niveli	Pozita	Vendi i lirë/Zëvendësim	Numri i pozitave
1	ShFMU	Mësimdhënës/e për informatikë	Vend i lirë	7
2	ShML	Mësimdhënës/e për informatikë	Vend i lire	1
3	ShFMU	Mësimdhënës/e për informatikë	Zëvendësim	3
4	ShML	Mësimdhënës/e për piano	Vend i lirë	4
5	ShML	Mësimdhënës/e për piano	Zëvendësim	1
6	ShML	Mësimdhënës/e për fiziarmunik	Vend i lire	1
7	ShML	Mësimdhënës/e për balet	Vend i lirë	1
8	ShML	Mësimdhënës/e për korepetitor	Vend i lire	1
9	ShML	Mësimdhënës/e për kitare	Vend i lire	2
10	ShML	Mësimdhënës/e për violinë	Vend i lirë	1
11	ShML	Mësimdhënës/e për këndim koral	Vend i lirë	1
12	ShFMU	Mësimdhënës/e për edukatë muzikore	Zëvendësim	2
13	ShFMU	Mësimdhënës/e për art figurativ	Vend i lirë	1
14	ShFMU	Mësimdhënës/e për art figurativ	Zëvendësim	2
15	ShML	Mësimdhënës/e nga fusha e elektroteknikës- elektronike	Vend i lirë	1
16	ShML	Mësimdhënës/e nga fusha e energjetikës	Vend i lire	1
17	ShML	Mësimdhënës/e për gjeodezi	Vend i lirë	1
18	ShML	Mësimdhënës/e për grafik	Zëvendësim	1
19	ShML	Mësimdhënës/e për ndertimtari	Zëvendësim	1
20	ShML	Mësimdhënës/e për profilin arsimor; Fizioterapi (Kujdesi shëndetësor me rehabilitim, bazat e masazhës, terapia fizikale etj.)	Vend i lirë	2
21	ShML	Mësimdhënës/e për profilin arsimor; në lëmine mjekësore	Vend i lire	2
22	ShML	Mësimdhënës/e për profilin arsimor; të Stomatologjisë (Protetika mobile – proteza totale)	Vend i lire	1

23	ShML	Mësimdhënës/e për Infermier (Instruktor)	Vend i lirë	1
24	ShML	Mësimdhënës/e për profilin arsimor- Farmaci	Vend i lirë	2
25	ShML	Mësimdhënës/e për profilin arsimor -Farmaci (paralelja boshnjake)	Vend i lire	1
26	ShML	Mësimdhënës/e nga fusha e ekonomisë	Vend i lire	1
27	ShML	Mësimdhënës/e për edukatë fizike	Zëvendësim	1

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë);
- Rezymeja personale (CV);
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), **certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara të noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj. Çdo certifikatë e diplomës më e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit, nuk do të merret parasysh;**
- Certifikata që nuk jeni nën hetime.
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimorë

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068 dhe Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimet Administrative përkatëse të MASHTI-it (UA Nr. 05/2015 dhe UA Nr. 05/2021) si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për teknologji - informative në shkollë të mesme të ultë dhe të lartë:

- Niveli master arsimor - Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për piano në shkollë të mesme të lartë:

- Fakulteti i Arteve – Master i muzikës Piano (kompletuar) ose master I pedagogjisë instrumentale (piano), kompletuar;

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për fiziarmonikë në shkollë të mesme të lartë:

- Fakulteti i Arteve – Master i muzikës (Studimet e kompletuara për instrumentin përkatës)

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për balet në shkollë të mesme të lartë:

- Fakulteti i Arteve – Master i muzikës (Studimet e kompletuara përkatëse)

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për korepetitor në shkollë të mesme të lartë:

- Master i muzikës – Piano (kompletuar) ose master i pedagogjisë instrumentale (piano) kompletuar;

- Master i muzikes – Piano ose master i pedagogjise instrumentale;
- Master i muzikes – pedagogji e pergjithshme (me punim masteri ne pedagogji pianistike);

Kriteret e kualifikimit për mësime dhënëse/e për kitarë në shkollë të mesme të lartë:

- Fakulteti i Arteve – Master i muzikës (Studimet e kompletuara për instrumentin përkatës)

Kriteret e kualifikimit për mësime dhënëse/e për violinë në shkollë të mesme të lartë:

- Fakulteti i Arteve – Master i muzikës (Studimet e kompletuara për instrumentin përkatës)

Kriteret e kualifikimit për mësime dhënëse/e për këndim koral në shkollë të mesme të lartë:

- Master i muzikës- dirigjim (kompletuar);
- Master i muzikës- dirigjim

Kriteret e kualifikimit për mësime dhënëse/e për edukatë muzikore në shkollë të mesme të ulët:

- Niveli master arsimor – pedagogji e përgjithshme muzikore (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor – pedagogji e përgjithshme muzikore (240 ECTS).

Kriteret e kualifikimit për mësime dhënëse/e për edukatë figurative në shkollë të mesme të ulët:

- Niveli master arsimor - Niveli master (300 ECTS, Programi – Pikturë/Skulpturë/Grafikë);
- Sistemi katërvjeçar (Programi – Pikturë/Skulpturë/Grafikë);
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS, Programi – Pikturë/Skulpturë/Grafikë).

Kriteret e kualifikimit për mësime dhënëse/e nga fusha e elektroteknikës- elektronike në shkollë të mesme të lartë:

- MSc. i elektroteknikës – elektronikës;
- Inxh. i dipl. i elektroteknikës- elektronikës.

Kriteret e kualifikimit për mësime dhënëse/e nga fusha e energjetikës në shkollë të mesme të lartë:

- MSc. i elektroteknikës – elektroenergjetikë industriale elektroenergjetike;
- Inxh. i elektroteknikës - elektroenergjetikë.

Kriteret e kualifikimit për mësime dhënëse/e për gjeodezi në shkollë të mesme të lartë:

- MSc. i gjeodezisë;
- Inxh. i diplomuar i gjeodezisë.

Kriteret e kualifikimit për mësime dhënëse/e për grafikë në shkollë të mesme të lartë:

- MSc. i grafikës;
- Inxh. i diplomuar i grafikës.

Kriteret e kualifikimit për mësime dhënëse/e për ndërtimtarin në shkollë të mesme të lartë:

- MSc. i ndërtimtarisë/ arkitekturës;
- Inxh. i diplomuar i ndërtimtarisë/ arkitekturës.

Kriteret e kualifikimit për mësime dhënëse/e për profilin arsimor; Fizioterapi, në shkollë të mesme të lartë:

- Master i fizioterapisë;
- Fizioterapeut i diplomuar.

Kriteret e kualifikimit për mësime dhënëse/e për profilin arsimor- në lëmin mjekësor, në shkollë të mesme të lartë:

- Mjek Specialist ;
- Mjeku.

Kriteret e kualifikimit për mësime dhënëse/e për profilin arsimor- Stomatologji, në shkollë të mesme të lartë:

- Specialist i Protetikës
- Stomatologu

Kriteret e kualifikimit për mësime dhënëse/e për profilin arsimor- Farmaci, në shkollë të mesme të lartë:

- Mr.Ph;
- Farmacisti i diplomuar:

Kriteret e kualifikimit për mësime dhënëse/e për praktikë profesionale: profilin arsimor- Infermieri (Instruktor), në shkollë të mesme të lartë:

- Master i infermierisë dhe mamive
- Mjeku specialist
- Mjeku

Kriteret e kualifikimit për mësime dhënëse/e nga fusha e ekonomisë në shkollë të mesme të lartë:

- MSc. i ekonomisë ;
- Ekonomist i diplomuar.

Kriteret e kualifikimit për mësime dhënëse/e për edukatë fizike në shkollë të mesme të ulët dhe të lartë:

- Niveli master arsimor - Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);

- Sistemi katërvjeçar;
- Bachelori (katërvjeçar 240 ECTS).

VËREJTJE: Sipas Udhëzimit administrativ (MASHTI) NR.05/2021 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, neni 7 paragrafi 25, *“Të gjithë kandidatët e kualifikuar në nivelin arsimor 300 ECTS për disiplinat nga paragrafi 1-24 të këtij neni, në fakultetet tjera përveç Fakultetit të Edukimit, të cilët i kanë filluar studimet para hyrjes në fuqi të UA nr.06/2015 të datës 10.07.2015, i plotësojnë kriteret për punësim”*. neni 11 paragrafi 3, *“Të gjithë të kualifikuarit në njësitë akademike që kanë përfunduar master arsimor 300 ECTS, kanë të drejtë të barabartë konkurrimi në arsimin para universitar të paraparë në nenin 6 dhe 7 të këtij Udhëzimit administrativ”*.

Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre ligjeve dhe UA nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kriterëve të konkursit publik, kandidatët do t'i nënshtrohen testimit me shkrim. Testi me shkrim në maksimum tërheqë 100 pikë apo deri në 50% të vlerësimit përfundimtar.

Kandidatët që arrijnë së paku 50% të pikëve nga testi me shkrim, i nënshtrohet intervistimit me gojë. Në intervistën me gojë, kandidatët mund të vlerësohen në maksimum deri 100 pikë apo 50% e vlerësimit përfundimtar.

Vlerësimi në intervistimin me gojë, bazohet në këto kritere:

Njohuritë e Përgjithshme 25 pikë,

Aftësitë e përgjithshme dhe Personalitetit 35 pikë dhe

Njohuritë profesionale 40 pikë (Ku përfshihen përvoja e punës dhe kualifikimi profesional gjatë studimeve).

Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë, mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjidhen në pozitat e lartcekura

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuar diplomat nga MASHT.

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test, intervistë, si dhe orari i intervistave publikohet në ëeb faqen e Komunës së Prishtinës <https://kk.rks-gov.net/prishtina/>(konkurset) dhe përmes e-mailit (sipas të dhënave në aplikacionin e kandidatit)

Fillimi i punës për vendet e cekura më lartë, nuk do të jetë domosdoshmërisht më datë 01.09.2021, por në varësi të lirimit real i vendit të punës në IEAA (datës së pensionimit apo pushimit të lehonisë etj.)

Me këtë konkurs zhvillohen procedurat e rekrutimit për vitin shkollor shtator, 2021 – gusht, 2022 (komplet viti shkollor). Në rast të ndonjë nevojë eventuale për mësimdhënës/e në IEAA, do të bëhen angazhime sipas renditjes së listave të publikuara me rastin e shpalljes së rezultateve.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur **15 ditë** nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit me: **19.07.2021 deri më datën 02.08.2021**.

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet në komunë përmes protokollit, përkatësisht përmes Qendrës për Shërbime me Qytetarë, në objektin e vjetër të Komunës së Prishtinës.

Nëse aplikohet për dy pozita (vend i lirë dhe zëvendësim), kandidatët duhet të dorëzojnë dy aplikacione të veçanta.

Pas aplikimit, kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit, e cila është e domosdoshme për fazat e tjera të procedurave të konkursit.